



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

VENDIM

Nr. 38, dt. 26.09.2025

***MBI MIRATIMIN E NXJERRJES JASHTË PËRDORIMIT TË DISA MATERIALEVE PER
KËSHILLIN E QARKUT***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit nr.10296 DT 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe udhëzimit nr 30 dt.27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, pas shqyrtimit të proces-verbalit të inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve të Këshillit të Qarkut Korçë deri në periudhën 31.12.2024, me propozim të Kryesisë, Këshilli i Qarkut Korçë

V E N D O S I

1. Të miratojë rezultatet e inventarizimit dhe vlerësimit të kapitalit për Këshillin e Qarkut për vitin 2024
2. Të miratojë nxjerrjen jashtë përdorimit nëpërmjet asgjesimit përfundimtar të materialeve të propozuara sipas listës bashkëngjitur.
3. Ngarkohet Sektori i Financës dhe Buxhetit të bëjë të gjitha sistemitet e nevojshme në kontabilitet
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Sektori i Financës dhe Buxhetit, Sektori juridik dhe i Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve, si dhe Sektori i Projekteve të Zhvillimit
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas ligjit.

KRYETARI

Erjon Nexhipi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT KORÇË

RELACION

***MBI MIRATIMIN E NXJERRJES JASHTË PËRDORIMIT TË DISA MATERIALEVE PER
KËSHILLIN E QARKUT***

Në mbështetje të Ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 77, Ligjit nr.10296 DT 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe udhëzimit nr.30 dt.27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, si dhe në zbatim të urdhërit të Kryetarit NR.27 DT.20.02.2025 “Për inventarizimin dhe vlerësimin e aktiveve të institucionit të Këshillit të Qarkut deri në periudhën 31.12.2024”, u krye inventarizimi i plotë i të gjitha vlerave materiale në administrim të Këshillit të Qarkut.

Komisioni i ngritur për këtë qëllim kreu inventarizimin në vend për çdo zyrë dhe ambient të Këshillit të Qarkut dhe në prani të personave përgjegjës. Në përfundim të inventarizimit komisioni përpiloi fletët e inventarizimit. Rezultatet e inventarizimit janë sipas përmbledhësës të vitit 2024.

Nga inventarizimi fizik nuk rezultuan diferenca në plus ose në minus krahasuar me inventarin kontabël. Por gjatë procesit të inventarizimit komisioni evidentoi një sërë materialesh inventar i imët të cilat janë pa vlerë përdorimi. Ato janë tërësisht të dëmtuara, të vjetëruara, të lëna prej kohësh në deponë të institucionit dhe nuk mund ti shërbejnë as njësisë tonë dhe as atyre të tjera. Vlera totale e materialeve të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi është 603 322.5 lekë dhe janë të gjitha materiale që ishin klasifikuar në llogarinë 327, nëpër pasqyrat kontabël të institucionit. Bashkëngjitur projekt vendimit do të gjeni edhe Raportin e vlerësimit dhe inventarizimit si dhe listën e materialeve për të cilën komisioni i inventarizimit në mbështetje të Ligjit Nr. 10296 date 08.07.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” si dhe udhëzimit Nr 30 date 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik” i propozon Këshillit nxjerrjen jashtë përdorimit dhe asgjësimin e tyre.

Korçë, më 18.09.2025

F.Firance
Oljona Beqiraj